



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština - Municipality of Prishtina

KRYETARI I KOMUNËS

14-351/05-85654/21, më 17. 05. 2021

Në bazë të dispozitave të nenit 13 dhe 58 të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", me 28/04, qershor 2008), të nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.02.2010, pas propozimit të Drejtorisë së Arsimit, Kryetari i Komunës së Prishtinës, merr këtë

V E N D I M

- I. Miratohet propozimi i Drejtorisë së Arsimit për lejimin e ndërtimit të shkollës fillore në lagjen "Kalabria" në Prishtinë.
- II. Lokacioni për ndërtimin e objektit të shkollës, sipas nenit I të këtij vendimi, përfshin pjesën e parcelës P 2896-0ZK Prishtinë.
- III. Ky vendim paraqet bazë për fillimin e procedurave për ndërtimin e shkollës fillore në lagjen Kalabria.
- IV. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Investimeve Kapitale dhe Menaxhim të kontratave, Drejtoria e Urbanizmit, Drejtoria e Arsimit.
- V. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.

I DORËZOHET:

- Drejtorive;
- Qendrës për shërbime me qytetar;
- Në dosje.

KRYETARI I KOMUNËS  
Shpend Ahmeti